



RAPORT TEKNIK

OBJEKTI:

**“Ndërhyrje për përmirësimin e shtresave asfaltike në Bashkinë
Kavajë dhe njësitë administrative të saj”**

“Rruga Memzotaj”

**PROJEKTUES:
BASHKIA KAVAJË**

TIRANE 2026

Qarku: **Tiranë**

NjVV: **Bashkia Kavajë**

Emertimi i Objektit: **“Ndërhyrje për përmirësimin e shtresave asfaltike në rrugën Memzotaj, Bashkia Kavajë”. L= 442ml.**

RAPORTI TEKNIK

Lenda: Mbi gjendjen ekzistuese dhe mënyren e ndërhyrjes në këtë aks rrugor.

➤ Të përgjithshme



Rruga Memzotaj ndodhet në fshatin Mamzotaj, njësi administrative Bashkia Kavajë. Ky segment rrugor është i banueshëm me objekte banimi shtëpia private dhe kryesisht i rrethuar me toka bujqesore.


Gjatësia e rrugës: L=442ml

Gjerësia e rrugës ekzistuese: L= 4-5ml

➤ **Gjendja Ekzistuese**

Rruga është e paasfaltuar nga ku paraqitet e amortizuar. Bankinat janë të mbuluara nga vegetacioni, nga ku mungon kanali drenazhimit. Ka prezence ujerash, gropa të mbushura me ujë dhe balte. Ajo kufizohet me godina banimi shtëpia private, toka bujqesore dhe mure rrethuese.








➤ Menyra e Nderhyrjes

Në progresivat 0+000.00-0+442.00 parashikohet nderhyrja me paketen e shtresave tip "E". Do te behet mbushje me gur gurore t=50cm, shtrese cakelli t=20cm, do te hidhet nje shtrese stabilizanti t=10cm, nje shtrese binder t=6cm bashke me Emulsion Bituminoz dhe do te behet asfaltimi i saj me nje shtrese asfaltobeton t=4cm bashke me Emulsion Bituminoz.

SEKSIONI TIP 8 Aplikohet në Progresivat: 0+000.00–0+442.00



Gjeresia e pjeses kaluese do te jete 4ml asfalt, e cila do te kufizohet me bankine stabilizanti 0.5ml nga te dyja anet.

Shenim: Shiko Profilet Tip dhe Planimetrine per llojin e ndërhyrjes.
